



KONTRATE

PER TRANSFERIM PRONESIE TE AKSIONEVE

Midis paleve kontraktuese :

Banka Kombetare Tregtare Sh.A., e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem **zoti Spiro Brumbulli**, ne cilesine e transferuesit te pronesise te aksioneve.

Ministria e Financave, e perfaqesuar nga **Departamenti i Thesarit - Drejtorja e Departamentit, zonja Mimoza Dhembli**, me autorizim te leshuar nga **Ministri i Financave**, ne cilesine e parnuesit te pronesise se aksioneve te transferuara nga Banka Kombetare Tregtare Sh.A.

Dhe

Bankes Arabe Shqiptare Islamike Sh.A., e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem, **zoti Abdul Waheed Alavi**, ne cilesine e miratuesit te transferimit te pronesise se aksioneve nga Banka Kombetare Tregtare tek **Ministria e Financave** e perfaqesuar nga **Departamenti i Thesarit**.

Ne Tirane, sot me daten 30.03.2000 (Dymije), mbeshtetur ne nenin 198 dhe 206 te Ligjit 7638 date 19.11.1992, ne nenin 13/d i ligjit Nr. 8365 date 2.07.1998 " Per Bankat ne Republiken e Shqiperise si dhe ne dispozitat e ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 " Mbi regjistrin Tregtar..", palet kontraktuese nenshkruan kete kontrate per transferim te pronesise se aksioneve, me kushtet qe vijojne :

1.- Me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve te Bankes Arabe Shqiptare Islamike dhe te Bankes se Shqiperise, Banka Kombetare Tregtare dhe Ministria e Financave bien dakord qe paketa e aksioneve qe Banka Kombetare Tregtare zoteron ne Banken Arabe Shqiptare Islamike te trasferohet ne Ministrine e Financave, e perfaqesuar nga Departamenti i Thesarit.

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Bankes Arabe Shqiptare Islamike Sh.A., e mbajtur me 05.07.1999, rikonfirmon transferimin e aksioneve te Bankes Kombetare Tregtare Sh.A. ne Ministrine e Financave, te perfaqesuar nga Departamenti i Thesarit, te miratuar edhe ne Mbledhjen e Jashtezakonshme te Aksionereve te dates 12.04.1999.

2.- Banka Kombetare Tregtare Sh.A. ne baze te Statutit te Bankes Arabe Shqiptare Islamike, te depozituar ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes, ne Regjistrin Tregtar, me Vendim te Gjykates se Tiranes Nr.4315/1 date 13.05.1999 eshte pronare dhe zoteron 40 % te paketes aksionere te Bankes Arabo Shqiptare Islamike, qe eshte si me poshte:

- Kapitali i nenshkruar 8.000.000,-USD, baras me 80.000 aksione.
- Kapitali i paguar 4.000.000,-USD, i ndare ne 2.300.000 USD ne kapital r e natyre dhe 1.700.000,-USD ne vlere monetare(cash).
- Vlera nominale e nje aksioni eshte 100,-USD

Banka Kombetare Tregtare Sh.A. me adrese Bulevardi " Zhan D'Ark " Tirane bie dakord qe paketren e aksioneve te permendur me siper ta trasferoje ne Ministrine e Financave, te perfaqesuar nga Drejtoria e Thesarit, ne adresen Bulevardi " Deshmoret e Kombit " Tirane.

3.-Ministria e Financave pranon te marre ne pronesi aksionet qe Banka Kombetare Tregtare ka patur ne zoterim, ne perputhje me statutin, ne Banken Arabo Shqiptare Islamike, duke fituar te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga cilesia e Aksionerit te Bankes Arabo Shqiptare Islamike.

- Banka Kombetare Tregtare Sh.A. me shkresen date 28 Maj 1999 te firmosur nga Drejtori i Pergjithshem i saj i kerkon Bankes Arabe Shqiptare Islamike Sh.A. transferimin e pronesise te aksioneve te saj.
- Banka e Shqiperise me shkrese Nr.1472/4 date 02.12.1999 ka dhene miratimin paraprak per realizimin e transferimit te pronesise se ketyre aksioneve, dhe njofton per kete veprim Banken Arabe Shqiptare Islamike Sh.A. dhe Ministrine e Financave.

4.- Banka Arabe Shqiptare Islamike Sh.A. informon Banken e Shqiperise dhe Ministrine e Financave me shkresen Nr. 138/99 date 5 Korrik 1999 dhe me shkresen Nr.137/99 date 5 Korrik 1999, per


transferimin e aksioneve te Bankes Kombetare Tregtare Sh.A. tek aksioneri i vetem - Ministria e Financave, e perfaqesuar nga Departamenti i Thesarit.

5.- Me transferimin e pronesise se aksioneve ne emert te Ministrise se Financave, te perfaqesuar nga Departamenti , Banka Kombetare Tregtare zh vishet nga çdo e drejt dhe detyrim mbi keto aksione.

BANKA KOMBETARE TREGTARE
Sh.A. E perfaqesuar nga

Drejtori i Pergjithshem

Z. SPIRO BRUMBULLI



BANKA ARABE SHQIPTARE
ISLAMIKE Sh.A

E perfaqesua nga
Drejtori i Pergjithshem

Z. ABDUL WAHEED ALAVI



MINISTRIA E FINANCAVE
E PERFAQESUAR NGA DEPARTAMENTI I THESARIT,
DREJTORIA E DEPARTAMENTIT, ME AUTORIZIM TE
MINISTRIT TE FINANCAVE.
Znj.MIMOZA DHEMBI

